



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada - Government**

*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspora*  
*Ministër of Foreign Affairs and Diaspora*

*Datë: 08.09.2023*

**FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES NË  
PROGRAMIN E DIPLOMASICË QYTETARE**

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pajtim me Vendimin nr. 11/89, i miratuar në mbledhjen e 89-të të Qeverisë së Republikës së Kosovë, e mbajtur më 9 gusht 2023, si dhe bazuar në thirrjen publike të datës 18.08.2023 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për aplikim në Programin për Diplomaci Qytetare, ftohen të interesuarit të aplikojnë për pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit dhe përzgjedhjen e kandidatëve në Programin e Diplomacisë Qytetare për vitin 2023-2024, si më poshtë:

- a)* anëtarë nga bota e akademisë brenda ose jashtë vendit – (në jeni jashtë vendit, duhet të jeni pjesëtar të diasporës/mërgatës, **(një anëtar)**);
- b)* anëtarë nga shoqëria civile brenda ose jashtë vendit - në jeni jashtë vendit, duhet të jeni pjesëtar të diasporës/mërgatës, **(dy anëtarë)**);

Përfaqësuesit e lartcekur do të jenë anëtarë të komisionit për vlerësimin e aplikantëve në kuadër të Programit për Diplomaci Qytetare për vitin 2023-2024, të pranuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas thirrjes publike të shpallur më 18.08.2023.

**Të interesuarit për aplikim për anëtar të komisionit duhet t'i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të ftesës publike:**

1. të kenë përvojë në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike;
2. të kenë përvojë në vlerësimin e kandidatëve ose projekteve të natyrës së njëjtë.

3. t'i njohin dokumentet strategjike dhe politikat në fushën e diplomacisë dhe të diasporës;
4. ta njohin bazën ligjore në fuqi në fushat që mbulon ftesa publike;
5. t'i njohin metodologjitë vlerësuese në komisione të ngjashme;
6. të kenë njohuri rreth dokumenteve të tjera relevante në fushën për të cilën është hapur ftesa publike;
7. njohje e legjislacioni në fushën e mbështetjes financiare publike .

Periudha e angazhimit do të jetë sipas afateve kohore të përcaktuara në Vendimin nr. 11/89, i miratuar në mbledhjen e 89-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e mbajtur më 9 gusht 2023

Pagesa do të jetë 430 euro për anëtar.

**Afati për aplikim është 5 ditë, nga data 08.09.2023 deri më 12.09.2023, në orën 10.00.**

**Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë CV-në.**

CV-të duhet të dërgohen në e-mail adresën: [zsp.mpj@rks-gov.net](mailto:zsp.mpj@rks-gov.net) - në subjekt të shkruhet **pozita për anëtar të komisionit, për të cilën aplikoni.**

**Aplikoj si përfaqësues i botës akademike  
apo  
Aplikoj si përfaqësues i shoqërisë civile.**

*Me respekt,  
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës*